




KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI



MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM

ndërmjet

Komunës së Gjilanit si autoritet publik

dhe

Besnik Haziri nga Gjilani, përfitues

Gjilan, 2022

Neni 1
Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje është përkrahja financiare e Besnik Hzirit nga Gjilani, për arritjen e rezultateve në gara ndërkombëtare për matematikë.
2. Marrëveshja është lidhur sipas procedurës së përcaktuar me Rregulloren për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 2/2018,01 nr. 016-28468 dt. 22. 03.2018 (neni 13dhe neni 14 paragrafi 1.8) dhe Rregullores për fondin e Ekselencës 01. nr. 17008 të datës 27.02.2017 (neni 4)

Neni 2
Vlera e Subvencionimit

Vlera e subvencionimit sipas nenit 1 paragrafi 1 të kësaj marrëveshje është **800 €** (tetëqind euro) dhe pagesa bëhet nga Kodi Buxhetor-Subvencione-Zyra e Kryetarit.

Neni 3
Obligimet e palëve

1. Obligimet e përfituesit së subvencionit janë:

- 1.1. Mjetet e marra, përfituesi do t'i shfrytëzoj vetëm për qëllimet siç u cekën më lartë.
- 1.2. Përfituesi duhet të raportoj tek Komuna e Gjilanit.

Neni 4

1. Obligimet e Komunës së Gjilanit janë:

- 1.1. Obligohet që shumën nga paragrafi 1 i nenit 2 të kësaj marrëveshje t'ia transferoj në xhirollogarinë bankare të përfituesit, sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshje;
 - 1.2. Bartja e mjeteve financiare do të bëhet në pajtim me rregullat financiare mbi pagesat.
2. Komuna e Gjilanit mbanë të drejtën e monitorimit/inspektimit dhe auditimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit, po që se paraqitet nevoja.

Neni 5

Kjo marrëveshje është e vlefshme pas datës së nënshkrimit nga palët.

Neni 6
Kthimi i mjeteve

Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve, përfituesi është i obliguar t'i kthejë mjetet e pa shpenzuara tek Komuna e Gjilanit.

Neni 7
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje eventuale lidhur me këtë marrëveshje, palët do ta zgjidhin vet, me synimin e përmirësimit dhe të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshje.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.

Neni 9


Marrëveshja është përpiluar në 2 kopje të njëjta, ku secila palë do të marrë nga një kopje.




Komuna e Gjilanit

Alban Hyseni, Kryetar

Për, Besnik Haziri, përfitues


Prindi, Fatmir Haziri



ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 , nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Gjiçanit 01. nr. 16-126211 të datës 06.11.2014, me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të datës 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjiçanit merë këtë:

V E N D I M

1. Me këtë vendim lejohet pagesa e mjeteve financiare në shumën prej 800 €(tetëqind euro) për Besnik Hazirin nga Gjiçani, për arritjen e rezultateve në gara vendore dhe ndërkombëtare për matematikë.
2. Pagesa e mjeteve financiare bëhet nga Kodi Buxhetor-Subvencione-Zyra e Kryetarit të Komunës.
3. Mjetet derdhen në emër të prindit z. Fatmir Haziri në xhironlogarinë [REDACTED] Banka.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Pjesë e këtij vendimi është Marrëveshja për Subvencionim.
6. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet

- Palës,
- DBF-së, dhe
- Arkivit.

Kryetari i Komunës

Alban Hyseni

